



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.981/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelet e kandidatit për anëtar në Kuvend Komunal në Pejë Elton Xhemajli nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohen pjesërisht** si të bazuar apelet Anr.981/2021, Anr.982/2021, Anr.983/2021 dhe A.nr.984/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtar në Kuvend Komunal në Pejë Elton Xhemajli nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj fletëvotimet vetëm kandidatet për anëtar në Kuvend Komunal në Pejë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në Vendvotimin 1725C/01R, 1723C/02R, 1727C/01R, 1727C/02R, BM117/001, BM117/002, BM117/003, BM217/001, BM217/002 dhe BM217/003.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet** si e pabazuar pjesa tjetër e apeleve, me të cilat ka kërkuar që të rinumrohen Vendvotimet 1707C/07D, 1707C/06R, 1726C/01R, 1707C/04R, 1705x/03r, 1713c/06D, 1713C/04R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.981/2021, Anr.982/2021, Anr.983/2021 dhe Anr.984/2021 i datës 04.11.2021, nga kandidati për anëtar në Kuvend Komunal në Pejë, Elton Xhemajli nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se ka mungesë të votave.

Në apelin Anr.981/2021 pretendon se ka fakte të pamohueshme se votat e ti janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa dëshmitarëve-familjarëve të tij. Duke qenë i bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në Qendrat e Votimit 1707C/07D, 1707C/06R, 1726C/01R, 1707C/04R, 1705x/03r, 1713c/06D, 1713C/04R, 1725C/01R të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve dhe miqve të ti në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i saj

është dëmtuar. Si dëshmi apelit i ka bashkangjitur deklaratat e personave që e kanë votuar ndërsa në këto vendvotime i figurojnë 0 vota.

Në apelin Anr.982/2021 pretendon se ka dyshime në lidhje me numërimin e votave nga diaspora, me të cilën thekson se votat e nisura nga Suedia me datën 06.10.2021 nga familja Nikqi me të cilën duhet të jenë me një klasë dhe ka dëshmi fotot e zarfeve, mirëpo nuk janë askund të numëruara, ndërkaq votat tjera që janë nisur nga pas datës 06.10.2021 janë të postuara në tri klasë të ndryshme. Kërkon nga PZAP-i të rishikohen edhe njëherë votat nga diaspora dhe si dëshmi ka bashkangjitur dy foto të zarfeve dhe pesë deklarata bashk me kopjet e letërnjoftimeve të votuesve të pretenduar nga Suedia.

Në Apelin Anr.983/2021, pretendon se në vendvotimin 1723C/02R në formularin e rezultateve në faqen e parë shihen 0 vota, ndërsa në faqen e dytë vërehet një shifër 8 dhe mbi të është shënuar një zero. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e një votueseje dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatit (FRK).

Në Apelin Anr.984/2021, pretendon se në vendvotimin 1727C/01R është votuar nga familjarët e tij dhe në rezultatet e paraqitura nuk i kanë dalur votat dhe tek lista e kandidatëve të subjektit politik PDK me nr.08 shihet se është e korigjuar dhe dyshohet se ka manipulime në këtë VV. Në VV 1727C/02R dyshohet se ka parregullsi në këtë VV gjatë të numrimit të votave.. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e tij dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatit (FRK) për VV e cekuar në apel.

Duke qenë i bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në Vendvotimet 1707C/07D, 1707C/06R, 1726C/01R, 1707C/04R, 1705x/03r, 1713c/06D, 1713C/04R, 1725C/01R, 1723C/02R, 1727C/01R, 1727C/02R dhe votat e diasporës sipas pretendimeve të apelit Anr.982-2 të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve dhe miqve të ti në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i saj është dëmtuar.

Në Përgjigjen e KQZ-së, lidhur me rastin Anr.982-2021 e pranuar më datë 07.11.2021 lidhje me numrin e votave të pranuar përmes postës theksohet se theksohet se votuesit e pretenduar: Ajshe Nikqi, me datë të lindjes 18.02.1952, Fatmir Nikqi, me datën të lindjes 09.08.1981 kanë pranuar pakon me fletëvotime, e cila është aprovuar, dhe e kanë proceduar për numërim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Ndërsa votuesit e cekur në apel Eloreta Sejdiqaj, Kushtrim Nikqi, me datën e lindjes 08.11.1991 dhe Asllan Nikqi, me datë të lindjes 14.07.1950, nuk janë të aprovuar në bazën e të dhënave që përmban votuesit të cilëve u janë aprovuar pakot me fletëvotime për shkak se nuk kanë aplikuar fare në periudhën e regjistrimit për aplikim ose iu janë refuzuar aplikacioni për regjistrim përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim dhe për këtë arsye nuk iu është proceduar fletëvotimi për numërim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apelet janë pjesërisht të bazuar**

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet

Anr.981/2021, Anr.982/2021, Anr.983/2021 dhe Anr.984/2021 i datës 04.11.2021 duke i trajtuar si një apel i evidentuar Anr.981/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtare në Kuvend Komunal në Pejë Elton Xhemajli nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Vendvotimet:1707C/07D, 1707C/06R, 1726C/01R, 1707C/04R, 1705x/03r, 1713c/06D, 1713C/04R, 1725C/01R, 1723C/02R, 1727C/01R, 1727C/02R, BM117/001, BM117/002, BM117/003, BM217/001, BM217/002 dhe BM217/003.

Paneli vlerëson se apelet janë pjesërisht të bazuar vetëm sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidati, ku shihet se nga deklaratat e gjithsej tre votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarinimin se në vendvotimin 1725C/01R e kanë votuar kandidatin Elton Xhemajli nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Gjithsej vota në këto vendvotime kanë rezultuar 1 vote derisa nga deklaratat e dëshmitarëve ishte dashur të jenë 3 vota. Në VV 1723C/02R, në Formularin e Rezultateve të Kandidateve në faqen e parë shihen 0 vota, ndërsa në faqen e dytë vërehet një shifër 8 dhe mbi të është shënuar një zero, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të Formularit të Rezultateve të Kandidatit ndërmjet faqes së parë dhe faqes së dytë ku vërehen ndërhyrje, pasi që fillimisht të njëjtit i janë shënuar 8 vota e më pas i janë përmirësuar në 0 vota. Në VV 1727C/01R, në Formularin e Rezultateve të Kandidatit nuk i figuron asnjë votë me të cilë vërehet se ka pasur ndërhyrje, fillimisht iu është shënuar 2 vota, pastaj 0 votë po ashtu në VV 1727C/02R, i është shënuar vetëm një votë. Në vendvotimet me postë BM117/001, BM117/002, BM117/003, BM217/001, BM217/002 dhe BM217/003, pas verifikimit të votave në këto VV lidhur me kandidatin në fjalë paneli konstatoi se ka 0 vota, ndërsa në përgjigjen e KQZ e kanë vërtetuar se dy votues të cekur në deklaratën e kandidatit në fjalë kanë pranuar pakon me fletëfotime dhe të njëjtën e kanë proceduar në QNR.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës me të cilën refuzohet si në pikën IV e pa bazuar ankesat për kutin për vendvotimet 1707C/07D, 1707C/06R, 1726C/01R, 1707C/04R, 1705x/03r, 1713c/06D, 1713C/04R pasi që në këto qendra të votimeve ka me shumë vota se deklarata çka e pamundëson që të dëshmohet se mund të ketë pasur manipulim në këto qendra të votimit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

Anr.981/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesues i Panelit**  
**Adrian Konushovci**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.